

UDHËZIM
Nr. 4, datë 28.6.2019

PËR DOKUMENTET PËR QARKULLIM DHE REGJISTRIM TË MJETEVE
RRUGORE

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 10, datë 27.12.2019; nr. 1, datë 18.1.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të pikës 4, neni 102 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 80, 92–102 dhe 220–224, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe neneve 237–252, 368 dhe 370, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 “Rregullorja e Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë,

UDHËZON:

Neni 1
Identifikimi i aplikantit

1. Aplikanti, që do të kuptohet individi, subjekti, ose përfaqësuesi ligjor i tyre, për të kërkuar shërbimet që përcakton ky udhëzim, duhet të identifikohet:

a) për individët, kartë identiteti, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikantit;

b) për subjektet, Ekstrakt i QKB-së në origjinal ose i printuar drejtpërdrejt nga faqja e internetit të QKB-së në sportel, i cili legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, si dhe autorizim për personin që do të kryejë veprimet, nëse nuk është përfaqësuesi ligjor i subjektit;

c) për subjektet që me ligj nuk regjistrohen në QKB, p.sh. institucionet shtetërore, diplomatike, organizatat joqeveritare etj., duhet vetëm fotokopje e NIPT-it, e njehsuar me origjinalin, me vulën zyrtare të institucionit përkatës, shoqëruar me autorizimin për personin që do të kryejë veprimet;

d) për shtetasit e huaj rezidentë në Republikën e Shqipërisë, leje qëndrimi e lëshuar nga organet kompetente të Ministrisë së Brendshme, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikantit;

e) për personelin e trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë, fotokopja e kartës identifikuese diplomatike/shërbimit me vulën e ambasadës.

KREU I

AUTOMJETET, MOTOMJETET, RIMORKIOT, MAKINAT BUJQËSORE DHE MAKINAT
TEKNOLOGJIKE

A. REGJISTRIMI I PARË

Neni 2
Shërbimi i regjistrimit të parë

1. Automjetet, motomjetet, rimorkiot, makinat bujqësore dhe ato teknologjike për të qarkulluar duhet të jenë regjistruar pranë sporteleve të drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, ose zyrave të shërbimit në varësi të DPSHTRR-së dhe të jenë të pajisura me dokumentacionin e nevojshëm dhe targë.

2. Me regjistrim të mjetit kuptohet kërkesa nga subjekti fizik ose juridik, identifikimi i treguesve të mjetit, pranimit i dokumentacionit, leximi automatik dhe/ose manual, evidentimi i të dhënave, si dhe lëshimi i lejes së qarkullimit, targës si dhe certifikatës së pronësisë së mjetit.

3. Regjistrimi i të dhënave të mjeteve dhe pronarëve ose përdoruesve legjitimë bëhet në regjistrin elektronik kombëtar, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 7 të këtij udhëzimi.

Neni 3

Identifikimi i treguesve të mjetit

(ndryshuar shkronja "e" e pikës 2, shfuqizuar pika 3, ndryshuar pika 4 dhe 6 me udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2022)

1. Aplikimi për regjistrimin fillon me identifikimin e treguesve të mjetit.

2. Identifikimi i treguesve të mjetit përmbledh:

a) këqyrjen fizike të mjetit me qëllim identifikimin e tij, bazë e të cilit është numri i identifikimit i stampuar në shasi;

b) leximin automatik dhe/ose manual për përcaktimin e saktë të karakteristikave teknike të mjetit duke i ballafaquar edhe me dokumentacionin teknik shoqërues;

c) hedhjen dhe pasqyrimin e të dhënave të lartpërmendura në Regjistrin Elektronik, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

d) printimin e të dhënave për identifikim të mjetit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

e) fotografi digjitale ku minimalisht të evidentohen: mjeti para-majtas; mjeti prapa-djathtas; numri i identifikimit; pllaka identifikuese; pamja brenda kabinës; dokumenti teknik i mjetit. Fotot të hidhen në sistemin informatik.

3. Shfuqizuar.

4. Çdo parregullsi e konstatuar evidentohet në dokumentin e identifikimit të treguesve të mjetit.

5. Identifikimi i treguesve të mjetit kryhet nga një specialist.

6. Identifikimi i treguesve të mjetit kryhet nga DPSHTRR-ja: për regjistrimin për herë të parë; për ndryshimin e pronësisë, me përjashtim të rasteve kur mjeti disponon një certifikatë të vlefshme kontrolli teknik; për ristampimin e numrit të identifikimit dhe kur konstatohen ndryshime të karakteristikave konstruktive apo funksionale të mjetit.

Përjashtohen nga kryerja e identifikimit të treguesve edhe mjetet e reja me motor, kur ndryshimi i pronësisë bëhet brenda periudhës për të cilët nuk kërkohet të bëhet kontroll teknik pas datës së regjistrimit të parë të tyre.

Neni 4

Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim

(hequr fjalë në pikën 4, shtuar shkronja "e" në pikën 4, ndryshuar pika 5 me udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2022)

1. Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e reja, të blera jashtë shtetit:

a) dokumenti i fitimit të pronësisë, i vlefshëm;

b) certifikatë përputhje ose dokument me të gjithë treguesit teknik të domosdoshëm për identifikimin e mjetit të lëshuar nga prodhuesi, në origjinal;

c) dokument që konfirmon kryerjen e procedurave doganore;

d) kontratën e sigurimit të mjetit sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF.

2. Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e reja, të blera në vend:

a) dokumenti i fitimit të pronësisë, i vlefshëm;

b) certifikatë përputhje ose dokument, me të gjithë treguesit teknik të domosdoshëm për identifikimin e mjetit, të lëshuar nga prodhuesi, në origjinal;

c) konfirmimi i procedurave doganore, si në pikën 1, germa "c", të këtij neni;

d) kontratën e sigurimit të mjetit sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF;

e) konfirmimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-RBS.

3. Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e përdorura, të blera jashtë shtetit ose në vend:

- a) dokumenti i fitimit të pronësisë, i vlefshëm;
- b) dokumentet shoqërues me treguesit teknikë dhe të pronësisë së mjetit, të lëshuar nga organet zyrtare të shtetit nga vjen mjeti si leje qarkullimi dhe/ose certifikatë pronësie, ose çregjistrim për eksport, në origjinal;
- c) konfirmimi i procedurave doganore, si në pikën 1, germa “c”, të këtij neni;
- d) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF;
- e) konfirmimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-RBS, për mjetet e përdorura të blera në vend.

4. Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e përdorura, të shitura me ankand nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore:

a) faturën tatimore shitje, të lëshuar nga institucionet e mësipërme (në origjinal), ose urdhrin e ministrit përgjegjës për transferimin kapital të mjetit në favor të një institucioni tjetër shtetëror (fotokopje e njëzuar me origjinalin);

b) fotokopjen e njëzuar me origjinalin të dokumentit mbi gjendjen fizike të mjetit në momentin e shitjes, në të cilin përveç të tjerave të evidentohet numri identifikimit të mjetit dhe sipas rastit mungesa e dokumenteve teknike shoqëruesit të mjetit;

c) konfirmimi i procedurave doganore, si në pikën 1, germa “c”, të këtij neni;

d) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF.

e) dokumentin teknik shoqërues të mjetit. Kur dokumenti teknik mungon kërkohet vërtetim nga institucioni që shet mjetin (nga AAPSK-ja ose Rezervat Materiale Shtetërore). Për mjetet që kanë qenë të regjistruara në Shqipëri dhe u mungon targa ose targat, në vërtetim të pasqyrohet dhe mungesa e tyre.

5 Dokumentet teknike dhe ato të fitimit të pronësisë, që janë në gjuhë të huaj, duhet të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara, me përjashtim të rasteve si më poshtë:

a) Certifikatat e konformitetit dhe dokumentet teknike të mjetit të lëshuara nga prodhuesi dhe që janë homologe me ato të BE-së;

b) Certifikatat e regjistrimit të plotësuara me kodet e harmonizuara të BE, si dhe certifikatat e regjistrimit të lëshuara nga vendet e BE-së;

c) Certifikatat e regjistrimit të lëshuara nga SHBA-ja, Kanadaja dhe shtete të tjera të plotësuara në gjuhën angleze.

Neni 5

Makinat bujqësore që i nënshtrohen regjistrimit

Makinat bujqësore, që i nënshtrohen regjistrimit dhe që pajisen me leje qarkullimi dhe targë janë:

a) traktorët bujqësorë;

b) makinat bujqësore teknologjike me dy ose më shumë akse;

c) rimorkiot bujqësore me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 1,5 tonë.

Neni 6

Pranimi i dokumentacionit

1. Aplikanti sipas nenit 1, aplikon pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, duke nënshkruar formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

2. Dorëzon sipas llojit të shërbimit dokumentacionin përkatës të përmendur në nenet 3 dhe 4, të këtij udhëzimi.

3. Zyra e regjistrimit, pranon dokumentacionin kur ai është i plotë si në formë dhe në përmbajtje dhe kur të dhënat e identifikimit të mjetit përputhen me ato të shënuara në dokumentacionin shoqërues. Në të kundërt, dokumentacioni i kthehet personit, së bashku me “Procesverbalin e refuzimit të shërbimit” ku përcaktohen saktë arsyet e mospranimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

Neni 7

Evidentimi i të dhënave, lëshimi i lejes së qarkullimit, certifikatës së pronësisë dhe targës

1. Të dhënat e mjetit dhe të pronarit evidentohen në:
 - a) sistemin informatik e-DPSHTRR;
 - b) Regjistrin Elektronik të mjeteve, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;
 - c) kartelën elektronike të mjetit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;
 - d) lejen e qarkullimit të mjetit, model DRM - 04, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja dhe miratuar nga ministri përgjegjës për transportin;
 - e) certifikatën e pronësisë së mjetit, model DRM - 05, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja dhe miratuar nga ministri përgjegjës për transportin.
2. Me dokumentacionin e dorëzuar krijohet dosja e mjetit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.
3. Kartela elektronike, pas çdo veprimi me mjetin, printohet dhe bashkëngjitet me dokumentet e tjera në dosje.
4. Mbas verifikimit dhe evidentimit të dhënave, zyra e regjistrimit i lëshon personit të interesuar lejen e qarkullimit, certifikatën e pronësisë dhe targën/at e mjetit.

Neni 8

Lëshimi i targës përsëritëse

(ndryshuar pika 1 , ndryshuar shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “d” të pikës 2 , shtuar pika 3 me udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2022)

1. Në rastet kur kërkohet targë përsëritëse, për karrel ose rimorkio me një aks deri në 750 kg, që i bashkëlidhet një automjeti, dorëzon:
 - a) dokumentacion të njëjtë me ato në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 4, edhe kur karreli vjen nga importi.
 - b) dokumentacion të njëjtë me atë të përcaktuar në nenin 4, pika 4, për karrelin e përdorur, të shitur me ankand nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore.
2. Zyra e regjistrimit:
 - a) bën regjistrimin në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;
 - b) shënon të dhënat të karrelit dhe lëshon dokumentin e regjistrimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;
 - c) lëshon brenda kohës së aplikimit targën përsëritëse, të njëjtë me atë të automjetit që do të bashkëlidhet;
 - d) me dokumentet e dorëzuara, krijohet fashikulli, i cili arkivohet.
3. Përdorimi i mjeteve të mësipërme, nga palët e treta, bëhet sipas rregullores së hartuar nga DPSHTRR-ja.

B. NDRYSHIMET NË REGJISTËR

Neni 9

Përditësimi i të dhënave të dokumentacionit për një mjet të regjistruar

Përditësimi i të dhënave të dokumentacionit për një mjet të regjistruar bëhet, kur:

- a) ndryshon vendbanimi ose gjeneralitetet e pronarit;

- b) ndryshon pronësia;
- c) humbet, vidhet, shkatërrohet ose dëmtohet leja e qarkullimit;
- d) humbet, vidhet, shkatërrohet ose dëmtohet targa;
- e) humbet, vidhet, shkatërrohet ose dëmtohet certifikata e pronësisë;
- f) ndryshim i karakteristikave konstruktive apo funksionale;
- g) shënohet numër i ri identifikimi.

Neni 10

Ndryshimi i vendbanimit ose gjeneraliteteve të pronarit të mjetit

(ndryshuar shkronja "d" e pikës 1, shkronja "e" e pikës 3, shkronja "e" e pikës 4, me udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2022)

1. Kur pronari i mjetit ndryshon vendbanimin, ai dorëzon në zyrën e regjistrimit të Drejtorisë Rajonale:

- a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;
- b) lejen e qarkullimit të mjetit;
- c) certifikatën e pronësisë së mjetit;
- d) kur pronari ndryshon vendbanimin, dorëzon targat detyrimisht nëse ato janë të modelit vjetër (të marrë para daljes së VKM-së nr. 724, datë 1.9.2010).

2. Kur pronari ndryshon vendbanimin brenda bashkisë, zyra e regjistrimit:

- a) bën ndryshimet në sistemin informatik e-DPSHTRR, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse duke vendosur adresën e saktë të vendbanimit sipas regjistrit të gjendjes civile;
- b) me dokumentet e dorëzuara krijohet fashikulli sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja, që futet në dosjen përkatëse të mjetit;
- c) lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;
- d) lëshon certifikatën e pronësisë së mjetit.

3. Kur pronari ndryshon vendbanimin brenda bashkive, që ka nën juridiksion Drejtoria Rajonale, zyra e regjistrimit:

- a) bën ndryshimet në sistemin informatik e-DPSHTRR, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse duke vendosur adresën e saktë të vendbanimit sipas regjistrit të gjendjes civile;
- b) sipas procedurave të miratuara nga DPSHTRR-ja magazinon targat, nëse ato janë sipas sistemit të vjetër;
- c) me dokumentet e dorëzuara krijohet fashikulli sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja, që futet në dosjen përkatëse të mjetit;
- d) lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;
- e) i dorëzon aplikantit targat e reja të mjetit, në zbatim të VKM-së nr. 778, datë 15.12.2021, në rastet kur ky i fundit ka pasur targa të modelit të vjetër (të marrë para daljes së VKM-së nr. 724, datë 1.9.2010);
- f) lëshon certifikatën e pronësisë së mjetit.

4. Kur pronari ndryshon vendbanimin jashtë juridiksionit të Drejtorisë Rajonale, zyra e regjistrimit e Drejtorisë Rajonale që ka nën juridiksion vendbanimin e ri:

- a) i bën kërkesë Drejtorisë Rajonale, ku mjete është i regjistruar për transferimin e dosjes së mjetit, sipas modelit të përcaktuar nga DPSHTRR-ja;
- b) bën ndryshimet në sistemin informatik e-DPSHTRR, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse duke vendosur adresën e saktë të vendbanimit sipas regjistrit të gjendjes civile;
- c) sipas procedurave të miratuara nga DPSHTRR-ja, magazinon targat e mjetit, nëse ato janë sipas sistemit të vjetër;
- d) lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;
- e) i dorëzon aplikantit targat e reja të mjetit, në zbatim të VKM-së nr. 778, datë 15.12.2021, në rastet kur ky i fundit ka pasur targa të modelit të vjetër (të marrë para daljes së VKM-së nr. 724, datë 1.9.2010);
- f) lëshon certifikatën e pronësisë së mjetit;

g) merr nga Drejtoria Rajonale, ku mjeti ka qenë i regjistruar, dosjen dhe vërtetimin e çregjistrimit të mjetit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

h) me dokumentet e dorëzuara, krijohet fashikulli sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja, që futet në dosjen përkatëse të mjetit.

5. Kur pronari i mjetit ndryshon gjeneralitetet, vepohet njëjloj si në pikën 1 dhe 2, të këtij neni.

Neni 11

Ndryshimi i pronësisë

(shtuar pikat 6, 7, dhe 8 me udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2022)

1. Kur ndryshon pronësia mbi mjetin, aplikanti, dorëzon në zyrën e regjistrimit të Drejtorisë Rajonale:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe Formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) dokumentin e fitimit të pronësisë të vlefshëm, në origjinal;

c) lejen e qarkullimit të mjetit;

d) certifikatën e pronësisë së mjetit;

e) konfirmimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-RBS.

f) kur pronari ndryshon bashkinë e vendbanimit dorëzon dhe targat, vetëm nëse ato janë të sistemit të vjetër.

2. Për mjetet e regjistruara në Arkivin Kombëtar të Mjeteve, që shiten me ankand nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 1, aplikanti dorëzon edhe këto dokumente:

a) Faturën tatimore të shitjes, të lëshuar nga institucionet e mësipërme (në origjinal), ose urdhrin e ministrit përgjegjës për transferimin kapital të mjetit në favor të një institucioni tjetër shtetëror (fotokopje e njëzuar me origjinalin);

b) fotokopjen e njëzuar me origjinalin të procesverbalit mbi gjendjen fizike të mjetit në momentin e shitjes, në të cilin përveç të tjerave të evidentohet numri identifikimit të mjetit dhe sipas rastit mungesa e dokumenteve teknike shoqëruese të mjetit dhe mungesa e targave.

3. Kur aplikanti ka vendbanimin në të njëjtën bashki me pronarin e vjetër, zyra e regjistrimit vepron njëjloj si në pikën 2 të nenit 10.

4. Kur aplikanti ka vendbanimin në një bashki tjetër, brenda juridiksionit të Drejtorisë Rajonale ku mjeti është i regjistruar, zyra e regjistrimit vepron njëjloj si në pikën 3, të nenit 10.

5. Kur aplikanti ka vendbanimin në një bashki jashtë juridiksionit të Drejtorisë Rajonale ku mjeti është i regjistruar, zyra e regjistrimit e Drejtorisë Rajonale që ka nën juridiksion vendbanimin e ri, vepron njëjloj si në pikën 4 të nenit 10.

6. Kontrata e shitblerjes së mjetit mund të bëhet edhe pranë DRSHTRR-ve, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

7. Për rastet kur mjeti është shitur dhe blerësi nuk ka bërë ndryshimin e pronësisë pranë zyrave të DPSHTRR-së, shitësi i mjetit, me kërkesë të tij, mund të bëjë, pranë DRSHTRR-së, deklarin për shitjen e mjetit, kundrejt tarifës përkatëse. Ngarkohet DPSHTRR-ja që të bëjë procedurat për evidentimin e regjistrimit të ndryshimit të pronësisë së mjetit, me deklarin nga shitësi.

8. Për rastet kur DPSHTRR-ja konstaton se pronari i ri i mjetit, referuar aktit të ndryshimit të pronësisë nuk ka kërkuar regjistrimin e ndryshimit të pronësisë, brenda 30 ditëve nga momenti i hartimit të aktit të ndryshimit të pronësisë, azhurnimit të lejes së qarkullimit apo marrëveshjeve për qiradhënie me të drejtë blerjeje, vijon mbledhjen e masës administrative, gjobë, sipas nenit 93 të Kodit Rrugor.

Neni 12

Humbja, vjedhja, shkatërrimi ose dëmtimi i lejes së qarkullimit

(ndryshuar me udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2022)

1. Në rastet e humbjes, vjedhjes ose të shkatërrimit të lejes së qarkullimit, aplikanti paraqitet në DRSHTRR-në që ka në juridiksion vendbanimin e zotëruesit, plotëson formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja, plotëson deklaratën e marrjes së përgjegjësisë administrative dhe kërkesën për pajisje me leje qarkullimi apo me leje të përkohshme qarkullimi, dhe dorëzon vërtetimin e denoncimit të lëshuar nga policia.

2. Zyra e regjistrimit:

a) verifikon të dhënat e shënuara në vërtetimin e denoncimit të lëshuar nga organet e policisë;
b) sipas kërkesës së bërë nga qytetari, lëshon lejen e qarkullimit ose lejen e përkohshme të qarkullimit, model DRM-08, sipas formatit të miratuar nga DPSHTRR-ja;

Krijohet fashikulli përkatës dhe sistemohet në dosjen e mjetit.

3. Kur zotëruesi i mjetit ka marrë leje të përkohshme qarkullimi, pasi të kenë kaluar 30 ditë nga data e vërtetimit të denoncimit, ai aplikon pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja dhe dorëzon lejen e përkohshme të qarkullimit të mjetit.

4. Zyra e regjistrimit, në rastet kur leja e qarkullimit nuk është gjetur ose dorëzuar brenda afatit prej 30 ditësh:

a) plotëson dhe lëshon lejen e re të qarkullimit;

b) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

c) me dokumentet e dorëzuara, plotësohet fashikulli, i cili sistemohet në dosjen e mjetit.

5. Në rastet e dëmtimit të lejes së qarkullimit (leja e qarkullimit konsiderohet e dëmtuar, kur ajo është bërë e papërdorshme, por e identifikueshme) aplikanti dorëzon:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) lejen e qarkullimit të dëmtuar.

6. Zyra e regjistrimit:

a) lëshon lejen e qarkullimit të re;

b) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

c) me dokumentet e dorëzuara, krijohet një fashikull, i cili sistemohet në dosjen e mjetit.

Neni 13

Humbja, vjedhja, shkatërrimi ose dëmtimi i targës

(ndryshuar me udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2022)

1. Në rastet e humbjes, vjedhjes ose shkatërrimit të targave bëhet pajisja e mjetit me targa të reja, menjëherë pas paraqitjes së vërtetimit të denoncimit të lëshuar nga policia.

Aplikanti paraqitet në DRSHTRR-në që ka në juridiksion vendbanimin e zotëruesit, plotëson formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja dhe dorëzon:

a) lejen e qarkullimit të mjetit;

b) certifikatën e pronësisë së mjetit.

c) targën për ato mjete që janë të pajisur me 2 targa dhe është denoncuar vetëm njëra.

2. Zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

b) magazinon targën, kur është denoncuar humbja e njëres prej tyre;

c) plotëson dhe lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;

d) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të pronësisë së mjetit;

e) lëshon targat e reja të mjetit.

Me dokumentet e dorëzuara, krijohet një fashikull, i cili sistemohet në dosjen e mjetit.

3. Në rastet e dëmtimit të targës, aplikanti bën aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja:

a) kur kërkohet të merren targa të tjera, të reja, ai duhet të dorëzojë:

- lejen e qarkullimit të mjetit;

- certifikatën e pronësisë; dhe

- targën/targat e mjetit.

4. Zyra e regjistrimit:

- a) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;
- b) magazinon targën/targat;
- c) plotëson dhe lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;
- d) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të pronësisë së mjetit;
- e) lëshon targat e reja të mjetit.

5. Kur kërkohet ristampim targe, shërbimi bëhet vetëm për mjetet që janë me targa, sipas VKM-së nr. 724, datë 1.9.2010 apo VKM-së 778, datë 15.12.2021.

Neni 14

Humbet, vidhet, shkatërrohet ose dëmtohet certifikata e pronësisë së mjetit

(ndryshuar pika 1 me udhëzimin nr. 10, datë 27.12.2019)

1. Në rastet e humbjes, vjedhjes, shkatërrimit ose dëmtimit të certifikatës së pronësisë së mjetit, aplikanti paraqet në portalin unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*:

- a) aplikimin dhe shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;
- b) deklarin për humbjen e certifikatës së pronësisë, e shprehur në modelin e shkronjës “a”, të pikës 1 të këtij neni.

2. Zyra e regjistrimit:

- a) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;
- b) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të pronësisë;
- c) me dokumentet e dorëzuara, krijohet një fashikull, i cili sistemohet në dosjen e mjetit.

Neni 15

Ndryshimi i karakteristikave konstruktive apo funksionale të mjetit

1. Në rastet e ndryshimit të karakteristikave konstruktive apo funksionale të mjetit, aplikanti dorëzon:

- a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;
- b) certifikatën e miratimit përfundimtar të ndryshimit lëshuar nga subjekti i licencuar nga MIE;
- c) lejen e qarkullimit të mjetit;
- d) certifikatën e pronësisë së mjetit.

2. Zyra e regjistrimit:

- a) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;
- b) plotëson dhe lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;
- c) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të pronësisë së mjetit, vetëm nëse ndryshojnë të dhënat që ajo përmban;
- d) me dokumentet e dorëzuara, krijohet një fashikull, i cili sistemohet në dosjen e mjetit.

Neni 16

Shënimi i numrit të ri të identifikimit të mjetit

1. Shënimi i numrit të ri të identifikimit të mjetit, bëhet vetëm nga zyra përgjegjëse në DPSHTRR, e cila lëshon aktin përkatës.

2. Aplikanti dorëzon:

- a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe Formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;
- b) lejen e qarkullimit të mjetit;
- c) certifikatën e pronësisë së mjetit.

3. Zyra e regjistrimit vepron njëloj si në pikën 2, të nenit 15.
4. Ngarkohet DPSHTRR të hartojë rregulla më të detajuara për procedurat e ri stampimit.

C. HEQJA NGA QARKULLIMI I MJETEVE

Neni 17

Heqja e përkohshme nga qarkullimi i mjeteve

(shtuar pikat 5 dhe 6 me udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2022)

1. Në rastet kur kërkohet çregjistrim i përkohshëm i mjetit, sipas nenit 9, pika 1 e ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, aplikanti pasi ka paguar detyrimet përkatëse për taksat e mjetit, dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe Formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) lejen e qarkullimit të mjetit;

c) targat e mjetit.

2. Zyra e regjistrimit:

a) bën shënimet në sistemin informatik për heqjen e përkohshme nga qarkullimi;

b) me dokumentet e dorëzuara krijohet fashikull, i cili së bashku me targat e mjetit ruhet në arkiv, në dosarë të veçantë;

c) lëshon vërtetimin e çregjistrimit të përkohshëm, sipas modelit të përcaktuar nga DPSHTRR-ja.

3. Në rastet kur kërkohet reregjistrimi i mjetit, aplikanti dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe Formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) dokumentin e çregjistrimit të përkohshëm.

4. Zyra e regjistrimit:

a) bën shënimet në sistemin informatik për përfundimin e heqjes së përkohshme nga qarkullimi të mjetit;

b) dokumentet e dorëzuara, i sistemon në fashikullin e krijuar për heqjen e përkohshme të mjetit nga qarkullimi, të cilin e sistemon në dosjen e mjetit;

c) konfirmon rikthimin në qarkullim me vërtetimin përkatës;

d) i kthen personit lejen e qarkullimit dhe targat e mjetit.

5. Heqja e përkohshme nga qarkullimi i mjetit bëhet me kërkesë të pronarit edhe në rastet kur ky i fundit dorëzon dokument ligjor nga institucionet ligjzbatuese, të cilat kanë sekuestruar mjetin.

6. Administrimi dhe ruajtja nga zyrat e DPSHTRR-së, i lejes së qarkullimit dhe i targave bëhet pa kosto deri në 5 vjet.

Për mosparaqitje të zotëruesit të mjetit, brenda 5 vjetësh nga data e çregjistrimit të përkohshëm, ruajtja e dokumenteve të qarkullimit dhe e targave bëhet kundrejt pagesës. Tarifa përcaktohet nga ministria përgjegjëse për transportin, me propozim të DPSHTRR-së.

Neni 18

Heqja e përhershme e mjeteve nga qarkullimi

(shtuar fjalë në fund të paragrafit të parë, ndryshuar shkronjat “b” dhe “d” të pikës 2, shtuar shkronja “h” në pikën 2, shtuar pikat 5, 6 dhe 7 me udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2022)

Heqja e përhershme nga qarkullimi bëhet kur mjete:

- eksportohet;

- del jashtë përdorimit, klasifikohet në mjet ‘Retro’.

1. Në rastet kur mjete eksportohet, aplikanti dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale ku mjete është i regjistruar, për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) lejen e qarkullimit të mjetit;

c) certifikatën e pronësisë së mjetit;

d) targat e mjetit.

e) nëse personi është shtetas i huaj, jo rezident në Shqipëri, si dokument identifikimi duhet fotokopje e noterizuar e pasaportës, ose e kartës së identitetit;

f) dokumentin e fitimit të pronësisë, kur ka ndryshim pronësie;

g) kur mjete i eksportuar është regjistruar në një shtet tjetër, dokumentet sipas germave “b”, “c” dhe “d”, nëse mungojnë do të zëvendësohen me vërtetimin në origjinal me konfirmimin përkatës të lëshuar nga autoritetet e shtetit që ka bërë regjistrimin, me vulë apostile.

2. Zyra e regjistrimit, sipas kërkesës nga aplikanti:

a) bën shënimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse.

b) plotëson dhe lëshon lejen e qarkullimit dhe lejen e qarkullimit ndërkombëtare, për rastet kur kërkohet;

c) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të pronësisë së mjetit, me shënimin “Për eksport”.

d) lëshon targat e përkohshme të mjetit, në zbatim të VKM-së nr. 153, datë 7.4.2000, të ndryshuar, për rastet kur mjete nuk është i regjistruar në një shtet tjetër;

e) kur ndryshon pronësia, dokumentet lëshohen në emër të pronarit të ri të mjetit.

f) lëshon vërtetimin zyrtar të heqjes së përhershme të mjetit nga qarkullimi për eksport, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

g) magazinon targat e mjetit.

h) Për mjetet e trupit diplomatik, me kërkesë të përfaqësuesve të tyre, si dhe për mjetet e regjistruar në një shtet tjetër, lëshohet vetëm vërtetim zyrtar i heqjes së mjetit nga qarkullimi për eksport.

3. Kur mjete del jashtë përdorimit, aplikanti dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) lejen e qarkullimit të mjetit.

c) certifikatën e pronësisë së mjetit.

d) targat e mjetit.

e) certifikatën e shkatërrimit lëshuar nga subjekti i licencuar për depozitimin e mjeteve në fund të jetës ose dokument të barasvlershëm nëse shkatërrimi ka ndodhur jashtë shtetit.

4. Zyra e regjistrimit:

a) bën shënimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

b) me dokumentet e dorëzuara, krijohet një fashikull, i cili sistemohet në dosjen e mjetit;

c) magazinon targat e mjetit;

d) lëshon vërtetimin zyrtar të heqjes së përhershme të mjetit nga qarkullimi për jashtë përdorimi, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

5. Kur mjete është klasifikuar në mjet “Retro” aplikanti paraqitet në drejtorinë rajonale që ka në juridiksion vendbanimin e zotëruesit të mjetit, plotëson formularin e aplikimit dhe dorëzon:

a) lejen e qarkullimit të mjetit;

b) certifikatën e pronësisë së mjetit;

c) targat e mjetit;

d) vërtetim nga komisioni që ka shpallur mjetin “Retro”.

6. Specialisti i zyrës së regjistrimit, sipas kërkesës bërë nga aplikanti:

a) verifikon dokumentet, bën verifikimet në sistem mbi detyrimet financiare;

b) kur plotësohen kërkesat bën shënimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

c) me dokumentet e dorëzuara, krijohet një fashikull, i cili sistemohet në dosjen e mjetit;

d) magazinon targat e mjetit;

e) lëshon vërtetimin zyrtar të heqjes së përhershme të mjetit nga qarkullimi për klasifikim të tij në mjet “Retro”, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

7. Ciklomotorët dhe motomjetet të hequra nga qarkullimi, si mjete “Retro”, me kërkesë të zotëruesit, pas një periudhe prej 6 muajsh si mjet Retro, mund të regjistrohen në regjistrin e mjeteve të DPSHTRR-së.

KREU II CIKLOMOTORËT

A. REGJISTRIMI I PARË

Neni 19

Shenja e identifikimit të ciklomotorit

1. Për t’u pajisur me shenjën e identifikimit të ciklomotorit, aplikanti, që plotëson kushtet sipas nenit 241 të Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor, dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

2. Zyra e Regjistrimit:

a) plotëson Regjistrin Elektronik të shenjave identifikuese të ciklomotorit;

b) hedh të dhënat në sistemin informatik;

c) plotëson dhe lëshon menjëherë dëshminë e shenjës identifikuese të ciklomotorit, model DRM - 10, sipas formatit të miratuar nga DPSHTRR-ja;

d) lëshon menjëherë shenjën e identifikimit të ciklomotorit;

e) me dokumentacionin e dorëzuar, krijohet dosja e mjetit.

Neni 20

Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim, certifikata e përshtatshmërisë teknike

(hequr shprehje në pikën 4, shtuar shkronja “e” në pikën 4, ndryshuar pika 5 me udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2022)

1. Dokumentacioni i nevojshëm për të marrë certifikatën e përshtatshmërisë teknike për ciklomotorët e rinj, të blerë jashtë shtetit:

a) dokumenti i fitimit të pronësisë, i vlefshëm;

b) certifikatë përputhje ose teknike, ose dokument me të gjithë treguesit teknik të domosdoshëm për identifikimin e mjetit, të lëshuar nga prodhuesi, në origjinal;

c) dokument që konfirmon kryerjen e procedurave doganore;

d) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR - AMF.

2. Dokumentacioni i nevojshëm për të marrë certifikatën e përshtatshmërisë teknike për ciklomotorët e rinj, të blerë në vend:

a) dokumenti i fitimit të pronësisë, i vlefshëm.

b) certifikatë përputhje ose teknike ose, dokument me të gjithë treguesit teknik të domosdoshëm për identifikimin e mjetit, të lëshuar nga prodhuesi, në origjinal.

c) konfirmimi i procedurave doganore, si në pikën 1, germa “c”, të këtij neni.

d) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR- AMF.

e) konfirmimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-RBS.

3. Dokumentacioni i nevojshëm për të marrë certifikatën e përshtatshmërisë teknike për ciklomotorët e përdorur, të blerë jashtë shtetit ose në vend:

a) dokumenti i fitimit të pronësisë, si në pikën 1, germa “a”, të këtij neni për ciklomotorët e blerë jashtë shtetit. Dokumenti i fitimit të pronësisë, si në pikën 2, germa “a” të këtij neni, për ciklomotorët e blerë në vend;

b) dokumentet shoqëruese me treguesit teknik dhe të pronësisë së ciklomotorit, të lëshuar nga organet zyrtare të shtetit nga vjen ciklomotori, si leje qarkullimi dhe/ose certifikatë pronësie, ose regjistrim për eksport, në origjinal;

c) konfirmimi i procedurave doganore, si në pikën 1, germa “c”, të këtij neni;

d) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF;

e) konfirmimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-RBS, për ciklomotorët e përdorur të blerë në vend.

4. Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e përdorura, të shitura me ankand nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore.

a) faturë tatimore shitje, të lëshuar nga institucionet e mësipërme (në origjinal), ose urdhrin e ministrit përgjegjës për transferimin kapital të mjetit në favor të një institucioni tjetër shtetëror (fotokopje e njësuar me origjinalin);

b) fotokopjen e njësuar me origjinalin të dokumentit mbi gjendjen fizike të mjetit në momentin e shitjes, në të cilin përveç të tjerave të evidentohet numri identifikimit të mjetit dhe sipas rastit mungesa e dokumenteve teknike shoqëruesit të mjetit;

c) konfirmimi i procedurave doganore, si në pikën 1, germa “c”, të këtij neni”;

d) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF.

e) dokumentin teknik shoqërues të mjetit. Kur dokumenti teknik mungon kërkohet vërtetim nga institucioni që shet mjetin (nga AAPSK-ja ose Rezervat Materiale Shtetërore).

5. Dokumentet teknik dhe ato të fitimit të pronësisë që janë në gjuhë të huaj, duhet të jenë përkthyer në shqip dhe të noterizuara, me përjashtim të rasteve si më poshtë:

- Certifikatat e konformitetit dhe dokumentet teknik të mjetit, të lëshuar nga prodhuesi dhe që janë homologe me ato të BE;

- Certifikatat e regjistrimit të plotësuara me kodet e harmonizuara të BE, si dhe certifikatat e regjistrimit të lëshuar nga vendet e BE;

- Certifikatat e regjistrimit të lëshuara nga SHBA, Kanada dhe shtete të tjera, të plotësuara në gjuhën angleze.

6. Zyra e regjistrimit, pasi verifikon dhe mban dokumentet, mbi bazën e tyre:

a) hedh të dhënat në sistemin informatik, plotëson Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

b) plotëson dhe lëshon menjëherë certifikatën e përshtatshmërisë teknike, model DRM - 12, sipas formatit të miratuar nga DPSHTRR-ja;

c) me dokumentet e dorëzuara, krijohet dosja e mjetit.

B. NDRYSHIMET NË REGJISTËR

Neni 21

Ndryshimi i vendbanimit të personit të pajisur me shenjën e identifikimit

1. Kur personi i pajisur me Shenjë identifikimi ndryshon vendbanimin, dorëzon në zyrën e regjistrimit të Drejtorisë Rajonale që ka nën juridiksionin e saj vendbanimin e ri:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe Formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) dëshminë e shenjës së identifikimit;

c) kur pronari ndryshon njësinë administrative të vendbanimit, dorëzon shenjën e identifikimit vetëm nëse ajo është sipas sistemit të vjetër.

2. Kur personi i pajisur me shenjën e identifikimit, ndryshon vendbanimin brenda njësisë administrative, Zyra e regjistrimit:

- a) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;
- b) me dokumentet e dorëzuara, krijon fashikull, i cili futet dosjen përkatëse të mjetit;
- c) plotëson dhe lëshon dëshminë e re të shenjës së identifikimit;

3. Kur personi i pajisur me shenjën e identifikimit, ndryshon vendbanimin brenda njësisë administrative që ka nën juridiksion Drejtoria Rajonale, Zyra e regjistrimit:

- a) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;
- b) sipas procedurave të miratuara nga DPSHTRR-ja magazinon shenjën e identifikimit, nëse ajo është sipas sistemit të vjetër;
- c) me dokumentet e dorëzuara, krijon fashikull, i cili futet në dosjen përkatëse të mjetit;
- d) plotëson dhe lëshon dëshminë e re të shenjës së identifikimit;
- e) i dorëzon aplikantit shenjën e re të identifikimit të ciklomotorit, në zbatim të VKM-së nr. 724, datë 1.9.2010, në rastet kur ky i fundit ka pasur shenjë identifikimi të sistemit të vjetër.

4. Kur personi i pajisur me Shenjën e identifikimit të ciklomotorit, ndryshon vendbanimin jashtë juridiksionit të Drejtorisë Rajonale, Zyra e regjistrimit:

- a) i bën kërkesë Drejtorisë Rajonale, ku personi ka qenë i regjistruar më parë, për dërgimin e dosjes;
- b) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;
- c) plotëson dhe lëshon dëshminë e re të shenjës së identifikimit;
- d) sipas procedurave të miratuara nga DPSHTRR-ja magazinon shenjën e identifikimit, nëse ajo është sipas sistemit të vjetër;
- e) i dorëzon aplikantit shenjën e re të identifikimit të ciklomotorit, në zbatim të VKM-së nr. 724, datë 1.9.2010, në rastet kur ky i fundit ka pasur shenjë identifikimi të sistemit të vjetër;
- f) me dokumentet e dorëzuara, krijon fashikull, i cili futet në dosjen e ardhur nga Drejtoria Rajonale ku personi ka qenë i regjistruar më parë.

Neni 22

Ndryshimi i vendbanimit të pronarit të ciklomotorit

1. Kur pronari i ciklomotorit ndryshon vendbanimin, dorëzon në zyrën e regjistrimit të Drejtorisë Rajonale që ka nën juridiksionin e saj vendbanimin e ri:

- a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;
- b) certifikatën e përshtatshmërisë teknike.

2. Kur pronari i ciklomotorit, ndryshon vendbanimin brenda bashkisë, Zyra e regjistrimit:

- a) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;
- b) me dokumentet e dorëzuara, krijon fashikull, i cili futet në dosjen përkatëse të mjetit;
- c) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të përshtatshmërisë teknike.

3. Kur pronari i ciklomotorit, ndryshon vendbanimin brenda bashkive që ka nën juridiksion Drejtoria Rajonale, Zyra e regjistrimit vepron njëjloj si në pikën 2 të këtij neni.

4. Kur pronari i ciklomotorit, ndryshon vendbanimin jashtë juridiksionit të Drejtorisë Rajonale, Zyra e regjistrimit, pasi i bën kërkesë Drejtorisë Rajonale, ku personi ka qenë i regjistruar më parë për transferimin e dosje dhe konfirmon mbërritjen e saj, vepron njëjloj si në pikën 2 të këtij neni.

Neni 23

Ndryshimi i pronësisë së ciklomotorit

1. Kur ndryshon pronësia mbi ciklomotorin, pronari i ri dorëzon në zyrën e regjistrimit të Drejtorisë Rajonale që ka nën juridiksionin e saj vendbanimin e ri:

- a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe Formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;
- b) aktin e fitimit të pronësisë së ciklomotorit, të vlefshëm;
- c) certifikatën e përshtatshmërisë teknike;

d) konfirmimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-RBS.

2. Për mjetet e regjistruara në Arkivin Kombëtar të Mjeteve, që shiten me ankand nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 1, aplikanti dorëzon edhe këto dokumente;

a) faturën e shitjes me TVSH, të lëshuar nga institucionet e mësipërme, (në origjinal), ose urdhrin e ministrit përgjegjës për transferimin kapital të mjetit në favor të një institucioni tjetër shtetëror (fotokopje e njëzuar me origjinalin);

b) fotokopjen e njëzuar me origjinalin të procesverbalit mbi gjendjen fizike të mjetit në momentin e shitjes, në të cilin përveç të tjerave të evidentohet numri identifikimit të mjetit dhe sipas rastit mungesa e dokumenteve teknike shoqëruese të mjetit dhe mungesa e shenjës identifikuese;

c) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF.

3. Kur pronari i ri ka vendbanimin në të njëjtën bashki me pronarin e vjetër, Zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

b) me dokumentet e dorëzuara, krijon fashikull, i cili futet dosjen përkatëse të mjetit;

c) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të përshtatshmërisë teknike.

4. Kur pronari i ri ka vendbanimin në një bashki tjetër, brenda juridiksionit të Drejtorisë Rajonale ku ciklomotori është i regjistruar, Zyra e regjistrimit vepron njëjloj si në pikën 3 të këtij neni.

5. Kur pronari i ri ka vendbanimin në një bashki jashtë juridiksionit të Drejtorisë Rajonale ku ciklomotori është i regjistruar, Zyra e regjistrimit pasi i bën kërkesë Drejtorisë Rajonale, ku personi ka qenë i regjistruar më parë për transferimin e dosjes dhe konfirmon mbërritjen e saj në arkiv, vepron njëjloj si në pikën 3 të këtij neni.

Neni 24

Humbja, vjedhja, shkatërrimi ose dëmtimi i shenjës së identifikimit, dëshmisë së shenjës së identifikimit, certifikatës së përshtatshmërisë teknike

(ndryshuar me udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2022)

1. Në rast humbjeje, vjedhjeje, shkatërrimi ose dëmtimi të shenjës së identifikimit (targë ciklomotori) apo certifikatës së përshtatshmërisë teknike, veprohet njëjloj si për rastet e ngjashme për automjete.

2. Për rastet:

a) e humbjes, vjedhjes ose shkatërrimit të dëshmisë së shenjës së identifikimit, pronari i ciklomotorit bën deklaram dhe pajiset nga zyra e regjistrimit me dëshmi të shenjës identifikuese dhe certifikatë të përshtatshmërisë teknike;

b) e dëmtimit të dëshmisë së shenjës së identifikimit, mbajtës i saj e dorëzon atë dhe pajiset nga zyra e regjistrimit me dëshminë e shenjës së identifikimit.

Neni 24/1

Ndryshimi i targës së mjetit

(shtuar me udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2022)

Ndryshimi i targës së mjetit bëhet për të gjitha shërbimet që parashikohen në këtë udhëzim, kur targat ekzistuese janë sipas sistemit të vjetër, të lëshuara para zbatimit të VKM-së nr. 724, datë 1.9.2010.

KREU III

MJETET RRUGORE TË VEÇANTA, HISTORIKE DHE JASHTË NORME

Neni 25

Regjistrimi i mjeteve rrugore të veçanta

Procedurat për regjistrimin e mjeteve rrugore të veçanta, kryhen sipas neneve përkatëse të këtij udhëzimi, në varësi të kategorisë, funksionit që kryen dhe pajisjeve apo sistemeve specifike që ka mjeti.

Neni 26

Regjistrimi i mjeteve rrugore historike

(ndryshuar me udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2022)

Për procedurat e regjistrimit të mjeteve historike në regjistrin përkatës, ngarkohet DPSHTRR-ja të miratojë aktet të tjera në zbatim të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; VKM-së nr. 153, datë 7.4.2000, të ndryshuar dhe këtij udhëzimi, në varësi të kategorisë së mjetit. Zyra e regjistrimit lëshon certifikatë njohjeje si mjet historik apo me interes koleksionimi, sipas formatit të miratuar nga DPSHTRR-ja.

Neni 27

Regjistrimi i mjeteve rrugore jashtë norme

Procedurat për regjistrimin e mjeteve jashtë norme, kryhen sipas neneve përkatëse të këtij udhëzimi, në varësi të kategorisë së mjetit. Regjistrimi bëhet vetëm në emër të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e transportit me mjete jashtë norme, sipas objektit të aktivitetit të deklaruar në QKB.

KREU IV

TARGA PROVË, E PËRKOHSHME DHE LEJA NDËRKOMBËTARE E QARKULLIMIT

Neni 28

Lëshimi i targës së provës

(shfuqizuar shkronja “a” e pikës 2, shfuqizuar pika 7 me udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2022)

1. Aplikanti si përfaqësues i subjektit juridik që plotëson kushtet sipas legjislacionit përkatës, për t’u pajisur me targë provë, dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) vërtetim të lëshuar nga administratori që konfirmon të dhënat e personit mbajtës të autorizimit për qarkullimin provë;

c) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF.

2. Zyra e regjistrimit:

a) shfuqizuar;

b) hedh të dhënat në sistemin informatik;

c) lëshon autorizimin për qarkullimin e provës me afat vlefshmërie 1-vjeçar, Model DRM- 34, sipas formatit të miratuar nga DPSHTRR-ja;

d) lëshon Librin për lëvizje me targë prove, i cili plotësohet paraprakisht kur del për qarkullimin e provës, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

e) lëshon targën e provës;

f) me dokumentet e dorëzuara, krijon dosjen.

3. Aplikanti, që plotëson kushtet sipas pikës 1 të këtij neni, për rinovimin e autorizimit për qarkullim provë, dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) vërtetim të lëshuar nga administratori që konfirmon të dhënat e personit mbajtës të autorizimit;

c) autorizimin për qarkullimin provë të skaduar;

d) librin e lëvizjes me targë prove.

4. Zyra e regjistrimit pasi verifikon dokumentacionin sipas pikës 1 të këtij neni:

- a) bën shënimet përkatëse në regjistrin e targave provë;
- b) lëshon autorizimin për qarkullimin e provës me afat 1-vjeçar.
- c) lëshon Librin për lëvizje me targë prove, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

5. Lëshimi i Librit të lëvizjes me targë provë pasi ka përfunduar, kryhet me kërkesën e aplikantit drejtpërdrejt pranë zyrës së regjistrimit, vetëm nëse ka një autorizim të vlefshëm.

6. Në rastin e humbjes së autorizimit për qarkullim provë, pasi të konfirmohet në sekretari vërtetimi i denoncimit të lëshuar nga organet e policisë për humbjen, lëshohet autorizimi i ri me afat 1-vjeçar, sipas pikës 4.

7. Shfuqizuar.

Neni 29

Lëshimi i targës së përkohshme dhe fletudhëtimit

Targa e përkohshme dhe fletudhëtimi lëshohen vetëm për qarkullim të përkohshëm të deklaruar.

1. Aplikanti, që plotëson kushtet e shprehura në nenin 98, pika 1 dhe 2, të ligjit 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, për t’u pajisur me targë të përkohshme, dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe Formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) deklarata duhet të përmbajë detyrimisht arsyen si edhe itinerarin e lëvizjes nga nisja deri në mbërritje;

c) vërtetim me treguesit teknik të domosdoshëm për identifikim të mjetit, lëshuar nga një servis i licencuar, ku të vërtetohet dhe garantohet siguri për qarkullimin në rrugë për sistemin e frenimit, drejtimit dhe sistemet e tjera të domosdoshme për qarkullim, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

d) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF.

2. Zyra e regjistrimit:

a) plotëson Regjistrin për targën e përkohshme, sipas modelit të përcaktuar nga DPSHTRR-ja;

b) hedh të dhënat në regjistrin elektronik të mjeteve;

c) plotëson dhe lëshon fletudhëtimin për qarkullim të përkohshëm sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

d) lëshon targën e përkohshme;

e) me dokumentet e dorëzuara, krijon dosjen.

Targa e përkohshme dhe fletudhëtimi do të dorëzohen detyrimisht pranë drejtorisë Rajonale. Në rast humbje, vjedhje ose dëmtimi veprohet si për rastet e ngjashme për targat dhe lejen e qarkullimit të përshkruara në këtë udhëzim. Mosdorëzimi përbën shkak për refuzim shërbimi për mjetin dhe për çdo shërbim tjetër për pronarin e identifikuar të mjetit dhe/ose personin që ka aplikuar për shërbim. Për këto të fundit do të njoftohet zyrtarisht edhe Policia e Shtetit ose Drejtoria e Policisë Vendore.

Neni 30

Lëshimi i lejes ndërkombëtare të qarkullimit

1. Për t’u pajisur me leje ndërkombëtare qarkullimi, aplikanti dorëzon:

a) lejen e qarkullimit kombëtare, e cila pas verifikimit i kthehet personit.

2. Zyra e regjistrimit:

a) plotëson Regjistrin elektronik të lejeve ndërkombëtare të qarkullimit.

b) plotëson dhe lëshon lejen ndërkombëtare të qarkullimit me afat vlefshmërie 3 vjeçar, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja, nëse nuk ka arsye të tjera ligjore për kufizim të këtij afati.

Neni 30/1

Përgatitja e rregulloreve dhe e procedurave

(shtuar me udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2022)

Ngarkohet DPSHTRR-ja, që, 30 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, të nxjerrë rregullore për administrimin e dokumenteve dhe procedurat e shërbimeve për mjetet, në zbatim të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, VKM-së nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të këtij udhëzimi.

Neni 31

Dispozita të fundit tranzitore

Ngarkohet DPSHTRR për zbatimin dhe plotësimin me aktet e nevojshme të këtij udhëzimi.

Afati i zbatimit të ndryshimeve në formularët e miratuar në këtë udhëzim, si dhe për ndryshimet e nevojshme në sistemin informatik e-DPSHTRR është jo më vonë se data 1 korrik 2019.

Afati i miratimit të formularëve që është ngarkuar DPSHTRR-së për t’i hartuar, është jo më vonë se data 1 korrik 2019.

Udhëzimi nr. 1, datë 18.1.2012 “Për dokumentacionin e qarkullimit dhe regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre” i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 32

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku